



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVNEDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenit 30 paragrafi 2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit nr.07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, nenet 15 paragrafi 2.4, dhe 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2020, miratoi këtë,

VENDIM PËR RIALOKIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020

Neni 1

1. Rialokohen mjetet nga granti qeveritar - 10, për Investime Kapitale – 30, si vijon;

1.1. Nga programi 66030 – Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ, kodi funksional - 0620, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:

• Asfaltimi i disa rrugëve ne fshatin Zakut, kodi-44545, shuma.....	10,996.09 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Surkish, kodi-46164, shuma.....	32,251.18 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bellopojë, kodi-46170,shuma.....	20,938.85 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Halabak, kodi-46172,shuma.....	30,477.70 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Pakashticë, kodi-46954,shuma.....	1,243.68 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Peran- kodi 49257,shuma.....	36,306.21 €
• Ndërtimi i rrugës në fshatin Penuhë, kodi-49258,shuma.....	33,368.02 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Letanc, kodi-49265, shuma.....	10,000.00 €
• Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Kaqybeg, kodi-49270, shuma.....	21,173.13 €
Totali.....	196,754.86 €

Rialokohen në:

-Rregullimi, riparimi, pastrimi i shtratit të Lumit Llap, kodi-43181, shuma.....	100,000.00 €
-Asfaltimi i disa rrugëve ne fshatin Batllavë, kodi-46439, shuma.....	40,000.00 €
-Asfaltimi i disa rrugëve ne fshatin Llapashticë, kodi-46946, shuma.....	20,000.00 €
-Ndërtimi i rrugës ne fshatin Kushevice,kodi-49268, shuma.....	36,754.86 €
Totali.....	196,754.86 €

1.2. Nga programi 73300 – Shërbimet e Shëndetësisë Primare, kodi funksional- 0721, Fondi burimor-10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi-30 :

- Ndërtimi i një Ambulance shëndetësore në fshatin Dumnicë, kodi-47165, shuma.....7,565.00 €
 - Pajisje për nxemje nga energjia solare, kodi-49353, shuma.....12,060.00 €
- Totali.....19,625.00 €**

Riallokohen në:

-Pajisje mjekësore, kodi-43187, shuma.....19,625.00 €

1.3. Nga nën programi 93120 – Arsim Fillor, kodi funksional- 0980, Fondi burimor-10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi-30 :

- Ndërtimi i shkollës fillore “Elfir Behrami” Metehi, kodi-47685, shuma.....22,237.94 €

Riallokohen në:

- Ndërtimi i shkollës “Ali Ajeti” në fshatin Balloc, kodi- 47693, shuma.....22,237.94 €

Neni 2

Riallokimi i mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi në kategorinë ekonomike Investime Kapitale, kodi-30, bëhet për arsye se në disa kode të projekteve ka tepriçë të mjeteve, ndërsa në disa kode tjera ka mungesë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-400/01-0071468/20
Podujevë, 23 nëntor 2020

